



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I43-2 Prot.
Nr. Dok. 202527772/2

Tiranë 13/11/2025

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarave,
paraburgosurave në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale
I.E.V.P. Pojskë.

Drejtuar: Z. Klevis QOSE
Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Znj. Fatbardha HOXHALLI
Drejtoreshë e IEVP Pojskë

POGRADEEC

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në I.E.V.P. Pojskë më datë 22.05.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues në vijim Mekanizmi Kombëtar ose MKPT, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila

Qafzezi, z. Hazbi Selita, z. Vullnet Topalli dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisionere pranë këtij Mekanizmi.

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit u takua fillimisht me drejtuesen e institucionit znj. Fatbardha Hoxhalli, e cila shprehu angazhimin dhe seriozitetin e duhur në trajtimin e çështjeve dhe gjetjen e zgjidhjeve për kërkesat e kryera. Grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për të kryer vizita në të gjithë ambientet që duhet të monitoronin, si dhe për zhvillimin e takimeve dhe intervistave konfidenciale me gratë e paraburgosura/dënuara.

Objektivi kryesor i inspektimit në I.E.V.P. Pojskë ishte vlerësimi i kushteve infrastrukturore që garantojnë sigurinë, jetesën, shëndetin dhe zhvillimin e aktiviteteve rekreative për të burgosurat që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre, trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, kontrolli dhe administrimi i dokumentacionit që evidenton punën e kryer sipas sektorëve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm¹.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit ligjor t'ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Vizita monitoruese e Mekanizmit Kombëtar në I.E.V.P. “Pojskë” ishte e paparalajmëruar dhe u zhvillua pa mbikëqyrjen e stafit duke zhvilluar biseda konfidenciale me të dënuarat dhe të paraburgosurat.

Drejtuesja e institucionit, pasi u njoh me planin e inspektimit, informoi lidhur me kushtet e trajtimit dhe situatën e respektimit të të drejtave të të dënuarave/paraburgosurave në këtë institucion. Në vijim, grupi inspektues kërkoi nga shefat e sektorëve dhe të shërbimeve, vënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit lidhur me organikën, programet vjetore të punës dhe aktiviteteve të sektorit juridik, sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, të shërbimit shëndetësor, sektorit të policisë etj.

Grupi i inspektimit u informua se në bazuar në nenin 24/1, të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë me nr.351, datë 27.06.2024, parashikohet se “*Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, i ndryshuar “Krijohet institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë, Pogradec klasifikohet burg për gra, me një seksion siguri e lartë, me një seksion siguri e zakonshme, me një seksion siguri e ulët dhe një seksion paraburgimi.

¹ Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimi i të dënuarave/paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë. Nr. K4/I73-2Prot datë 12.11.2024.

I.E.V.P. Pojskë është ndërtuar në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe Komitetit për Parandalimin e Torturës ndër vite. Qëllimi kryesor i sistemit penitenciar është riedukimi i personave në konflikt me ligjin, duke u ofruar atyre mundësi për një jetë të re dhe më të mirë pas përfundimit të dënimit.

Ky riedukim realizohet përmes arsimimit dhe trajnimeve profesionale, të cilat ndihmojnë të dënuarat të zhvillojnë aftësi të reja dhe të përgatiten për të ardhmen. Kjo qasje synon t'u japë atyre shpresë dhe mundësi për një fillim të ri, duke i mbështetur ato të rintegrohen në shoqëri si qytetare të përgjegjshme dhe të vlefshme.

Ky institucion ka një **kapacitet maksimal prej 90 personash**. Numri i grave të paraburgosura dhe dënuara në momentin e inspektimit në raport me kapacitetin e IEVP-së është 24 dënuara dhe 48 të paraburgosura në total 72 të burgosura.

Nga data 01.01.2025 deri në datën 22.05.2025 gjendja e popullimit paraqitet si më poshtë:

Muaji Janar: 51 paraburgosura 24 dënuara , gjithsej 75

Muaji Shkurt: 51 paraburgosua 24 dënuara, gjithsej 75

Muaji Mars: 53 paraburgosura 23 dënuara, gjithsej 76

Muaji Prill: 48 paraburgosura 23 dënuara, gjithsej gjithsej 71

Muaji Maj: 48 paraburgosura 24 dënuara, gjithsej gjithsej 72.

Në I.E.V.P. Pojskë rezulton se nuk ka popullim jashtë kapaciteteve të miratuara. Përgjatë inspektimit u këqyrën të gjitha dhomat e banimit të të burgosurave dhe u konstatua se shpërndarja e tyre ishte e barabartë.

I.E.V.P. “Pojskë” sipas organikës së miratuar me Urdhrin Nr. 68 datë 30.04.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë të saj” përbëhet nga: sektori civil 42 punonjës dhe sektori policor 71 punonjës në total me 113 punonjës.

Organika e plotësuar si dhe vendet vakante në staf paraqiten si më poshtë:

Në sektorin e Administratës Organika e miratuar për 42 punonjës gjendja faktike 39.

Mungesat janë:

- 1(një) punonjës (Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Shoqërore);
- 1(një) punonjës (Specialist Punonjës Social në Sektorin e Çështjeve Shoqërore);
- 1(një) punonjës (Sanitar i Regjimit të Brendshëm);

-Në sektorin e Policisë Organika e miratuar për 71 punonjës gjendja faktike 63.

Mungesat janë:

- 6 (gjashtë) punonjës së rolit të mesëm
- 2(dy) punonjës së rolit bazë.

Në bashkëbisedimin me drejtuesen e këtij institucioni, grupi inspektues kërkoi një informacion të përgjithshëm mbi gjendjen e respektimit të të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurave nga ana e stafit dhe punonjësit e policisë së institucionit, si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave pranë organeve eprore, për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

1. Ishin marrë masat pjesërisht për plotësimin e vendeve vakante me 1 farmacist dhe 1 infermiere.
2. Ishin marrë masat për sigurimin e ujit të ngrohtë në ambientin e dusheve në vazhdimësi për të siguruar larjen dhe ruajtjen e higjienës vetjake për të burgosurat.
3. Ishin marrë masat për shtimin e një kompjuteri në dhomën ku të paraburgosurat/dënuarat mund të kryejnë takimet online me familjet e tyre.
4. Ishin marrë masat për rritjen e numrit të aktiviteteve, me qëllim që të paraburgosurat/dënuarat, të kenë aktivitete të shumta edukative, sportive dhe të mundësohet që të zhvillojnë edhe aktivitete tjera, me të cilat shprehin talentin në punën dhe zanatet që zotërojnë.
5. Ishin marrë masat për hapjen e kurseve të formimit profesional në institucion me qëllim riaftësimin dhe riintegrimin e të dënuarave/ paraburgosurave.
6. Ishin marrë masat për fillimin e zhvillimit të procesit arsimor, ku pjesë e këtij procesi janë të burgosurat të cilët nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar gjithashtu dhe arsimin e mesëm.
7. Ishin marrë masat për plotësimin e të drejtës të të paraburgosurave/ dënuarave për krijimin e ambienteve për ushtrimin e riteve fetare në institucion.
8. Ishin marrë masat për të afishuar në të gjitha ambientet e regjimit të brendshëm të drejtat dhe detyrimet e të paraburgosurave/dënuarave të akomoduar në institucion për të qenë sa më të aksesueshme për to.

9. Ishin marrë masat për ndryshimin e menysë së ushqimit për ta bërë atë sa më të larmishme dhe përshtatjen e vakteve ushqimore, sipas normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, gjendjes shëndetësore, kushteve klimaterike, besimit fetar dhe nevojave të veçanta të tyre.

Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar si vijon:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për miratimin e Rregullores së Brendshme të IEVP-së Pojskë.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e vendit vakant të mjekut me kohë të plotë me 2 mjekë me kohë të pjesshme në institucion.
3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për vendosjen e mbulesave të bokseve të ajrimit, për të ndaluar futjen e ujit në kohë me shi.
4. Nuk ishin marrë masat për pajisjen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit në përputhje me nevojat shëndetësore të të burgosurave.
5. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucionit, 1 punonjës përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Shoqërore, 3 punonjës në sektorin e Burimeve Njerëzore dhe në staf policor me 5 punonjës të rolit të mesëm dhe 6 punonjës të rolit bazë.

Sa më sipër Avokati Popullit vlerëson Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë, veçanërisht në krijimin e kushteve të përshtatshme për të bërë të mundur rehabilitimin e të burgosurave dhe për të krijuar kushtet e përshtatshme qëndrimi.

Trajtimi i të dënuarave/paraburgosurave

Grupi i inspektimit kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimit të forcës fizike apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjedhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisionin për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësinë e ushqimit, furnizimin sipas normativës me detergjente dhe mjete të higjienës personale.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarat dhe të paraburgosurat, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste dhe pretendime për presion psikologjik apo mungesë komunikimi nga ana e punonjësve të policisë, gjithashtu nuk pati pretendime apo ankesa lidhur me keqtrajtime dhe tejkalim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni.

Por shqetësim i veçantë nga ana e të paraburgosurave ishte fakti se një bashkëvuajtëse e tyre ju shkakton presion psikologjik, zhurma dhe situata të papritura. Sipas tyre ky shqetësim vjen prej faktit se ka një privilegjim nga ana e Shefes së Sigurisë ndaj personit dhe ky problem ndonëse e kishin referuar nëpërmjet ankesave të vazhdueshme nuk kishin gjetur zgjidhje.

Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në Kreun 2 “Parimet Themelore”, neni 5 “Respektimi i të drejtave të njeriut” pika 4 parashikon se: *“Gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore, që sjell dëmtim fizik, seksual ose **psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, që dënohet sipas legjislacionit në fuqi.**”* Avokati i Popullit kërkon me forcë reagimin e menjëhershëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe nga Stafi i I.E.V.P. “Pojskë” të evidentojë sa më shpejt problematikën dhe trajtimin e ankesave të të dënuarave dhe paraburgosurave të cilat ishin nën presion psikologjik të vazhdueshëm.

Gjithashtu problematika dhe ankesat e parashtruara nga gratë e burgosura përgjatë inspektimit, ishin përgjithësisht për **mënyrën dhe trajtimin e tyre gjatë shoqërimit për në gjykatat respektive nga forcat operationale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve**. Sipas tyre shpesh herë këta të fundit, përdornin ndaj tyre gjuhë komunikimi fyese dhe shoqërimi i tyre kryhej nga **personel burra**, kjo në kundërshtim me nenin 41 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve ku përcaktohet se, *“1. Shoqërimi i grave të burgosura jashtë institucionit kryhet nga personeli i së njëjtës gjini të grupeve të sigurisë dhe/ose forcave operationale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke respektuar dinjitetin e gruas që shoqërohet, pika 2. Shoqërimi i grave të burgosura bëhet mbi bazën e një plani masash të mirëpërcaktuara, në vlerësimin e riskut, në prova, të dhëna inteligjente, planin e bashkëveprimit me autoritete të rendit dhe sigurisë, duke harmonizuar mjete të përshtatshme dhe efikase për të garantuar vendimmarrje profesionale. pika 3. Gjatë shoqërimit tregohet kujdesi i duhur për ta ekspozuar sa më pak të burgosurën në publik dhe duke marrë masa mbrojtëse për të siguruar anonimin. pika 4. Në të gjitha rastet, shoqërimi i të burgosurës bëhet me dokumentacionin përkatës”*.

Mungesa e tendave në ambientet e ajrimit si një problem i vazhdueshëm për to, si për periudhën e dimrit po ashtu edhe ato të verës. Sipas bisedës me drejtuesen e institucionit vendosja e tendave ishte një problematikë e zgjidhur dhe kjo do të realizohej brenda një kohe të shkurtër.

Të burgosurat ngritën shqetësimin se çdo çmim i artikujve ushqimorë të lejuara për tu tregtuar janë të vendosura në sistemin e platformës elektronike dhe ato janë të larta në krahasim me tregun dhe cilësinë e produkteve të ofruara.

Qëndrimet për këto ankesa do të trajtohen më poshtë me pasqyrimin e gjetjeve përgjatë këtij inspektimi.

Masat mbrojtëse

Në përputhje me standardet e përgjithshme të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të të burgosurve në veçanti, grupi i inspektimit u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku ishin të evidentuara praktikët e punës sipas sektorëve, me qëllim vlerësimin e kushteve dhe trajtimin e të dënuarave dhe të paraburgosurve.

Ekspertët fillimisht morën informacion në lidhje me procedurat e ndjekura për pritjen e të burgosurve në institucion, si dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes. Nga intervista e zhvilluar me drejtuesin e institucionit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit grupi i inspektimit konstatoi se, procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte dhe regjistrat e dosjet personale të të burgosurve ishin plotësuar sipas rubrikave.

Me paraqitjen e të burgosurës në IEVP “Pojskë” krijohet komisioni i pritjes për të pranuar të burgosurat, i cili verifikon identitetin dhe saktësinë e dokumentacionit.

Kur identiteti dhe dokumentacioni është i rregullt, hartohet procesverbali i pranimit të të burgosurës, dokumenteve shoqëruese dhe sendeve të saj personale. Në procesverbal shënohet data dhe ora e pranimit dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të pritjes.

- Komisioni pritjes e informon të burgosurën në një gjuhë të kuptueshme dhe që njihet prej saj për rregulloren e institucionit, të drejtat dhe detyrimet, të drejtën për këshillim dhe ndihmë ligjore, si dhe rregullat e procedurat për paraqitjen e kërkesave dhe ankesave duke i vënë në dispozicion materialet përkatëse.
- Komisioni i pritjes përbëhet nga një përfaqësues i sektorit ligjor, një përfaqësues i sektorit të çështjeve shoqërore, një përfaqësues i shërbimit shëndetësor dhe një përfaqësues i shërbimit të sigurisë. Komisioni i pritjes merr kontaktin e parë me të burgosurin dhe njihet me problemet, personalitetin, rrethikshmërinë e të burgosurit për sigurinë e të burgosurve të tjerë ose të personelit dhe e informon për mënyrën e jetesës gjatë kohës së qëndrimit në institucion. Në regjistrin e komisionit të pritjes evidentohen:

- Të dhënat personale;
- Të dhënat familjare;

- Arsimi;
- Profesioni;
- Vepra penale për të cilën akuzohet ose për të cilën është dënuar;
- Konfliktet e mundshme.

Vëmendje e veçantë ju kushtua mënyrës si funksiononte sistemi i kërkesë/ankesave. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, rezultoi se kërkesat dhe ankesat e të burgosurve ishin të regjistruara në regjistrin përkatës dhe ishin të protokolluara.

Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit dhe nga verifikimi i regjistrit të kërkesave të të dënuarave numri i kërkesë/ankesave për muajin prill 2025 për të gjithë sektorët ishte 61 në total.

Të burgosurat pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese e dorëzonin më pas te punonjësit e sektorit psiko-social. Punonjësi i sektorit psiko-social i dërgonte formularët në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit. Në varësi të natyrës të kërkesë/ankesës, sektori përgjegjës i ngarkuar nga drejtori i institucionit i kthente përgjigje me shkrim, ose drejtori/punonjësit e institucionit zhvillonin takime me të burgosurit sipas rastit brenda afatit 3(tre) ditor.

Sipas shënimeve në regjister, objekti i kërkesave kishte të bënte me kërkesa për takime me familjarë, kërkesë për takim me avokatë, vizita në spital ose kërkesa për blerje të ndryshme.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional në të gjitha ambientet e I.E.V.P. Pojskë dhe pamjet filmike ruheshin për 30 ditë. Mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të burgosurve, ashtu dhe nga vetë punonjëset e policisë së burgjeve. Dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarave dhe të paraburgosurve.

Nga kontrolli i dokumentacionit konstatuam se për 2 muajt e fundit ishin kryer:

Shoqërime në gjykatë 32;

Shoqërime në spitalin e burgut 12;

Takime me familjarë 33;

Komunikim online me familjarë 110;

Takime me Prokurorë/OPGJ/Avokatë/Noterë/Shërbim prove 37.

Aparatet e telefonave ishin në gjendje pune dhe nga intervistat me të burgosurat, ato deklaruan se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 16 telefonata në muaj.

Nga verifikimi i aparateve telefonik me kartë u konstatua se, të dënuarat mund të lidheshin me numrin e telefonit të Avokatit të Popullit (pa pagesë). Sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve: “I burgosuri mund të komunikojë në telefon me Avokatin e Popullit pa pagesë dhe në çdo kohë, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve. Numrat e telefonit të Avokatit të Popullit nuk përfshihen në listën e numrave të telefonit, të miratuar për çdo të burgosur”.

Ndërkohë që në këtë institucion ishin vendosur dy ambiente ku të paraburgosurat/dënuarat mund të kryenin 1 (një) takim online në muaj me familjet e tyre nëpërmjet platformës “*Microsoft Teams*” dhe ishin të pajisura me nga një kompjuter secili. Të gjitha takimet online të zhvilluara evidentoheshin në regjistrin përkatës.

Referuar në Ligjin Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, VKM nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve , kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”, si dhe në zbatim të urdhrit Nr.244, Prot, datë 10.02.2024 të Drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve , në IEVP Pojskë ishin të punësuar 8 të burgosura përkatësisht 6 të dënuara dhe 2 të paraburgosura në funksionet si: Parukeri, magazinieri dhe mirëmbajtëse e ambienteve të përbashkëta, lavanderi, lulishtare dhe ndihmës kuzhinierë. Nga takimi i grupit inspektues me të dënuarat dhe paraburgosurat që punonin brenda institucionit këto të fundit nuk kishin pretendime për kushtet e punës si dhe të gjitha kishin lidhur kontratat e punësimit.

Kushtet materiale

IEVP Pojskë është një institucion i ri i vuajtjes së dënimit i hapur në muajin korrik 2024, kjo strukturë moderne është ndërtuar me standardet më të mira të akomodimit të të burgosurve, në përputhje me rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT), e cila ka të akomoduar vajzat dhe gratë në konflikt me ligjin.

IEVP Pojskë është i përbërë nga një ndërtesë 4 katëshe e ndarë në dy pjesë, pjesa e regjimit dhe ajo e Administratës. Rregjimi i të burgosurve është i përbërë nga 6 (gjashtë) sektorë të ndarë nga dy sektorë në çdo kat, ku çdo sektor ka 7 qeli me përmasa 3x4. Dhomat e banimit kishin tualete brenda, dritare me përmasa të tilla që mundësonin ajrimin dhe dritën natyrale. Dhomat e banimit ishin të pajisura me nga dy krevate, dollap për mbajtjen e teshave dhe tavolina. Çdo sektor është i pajisur me një dhomë dushi me 4 ambiente për larje. Gjithsej në institucion ndodheshin 3 dhoma observimi dhe 3 dhoma veçimi, të gjitha ambientet ishin në kushte të mira dhe të pastra.

Ambientet e përbashkëta në institucion janë:

- 1 palestër për ushtrime fizike dhe aktivitet sportiv e pajisur me të gjitha mjetet bashkëkohore;
- 1 parukeri, ku të burgosurat përfitojnë mundësinë e kujdesit ndaj vetes;
- 1 bibliotekë e pajisur me një larmishmëri titujsh librash të ndryshëm;
- 1 ambient kuzhine, ku të burgosurat mund të gatujnë vetë ushqimin;
- 1 dhomë diskutimi e cila shërbente për takimin e të burgosurave me stafin social;
- 1 dhomë për punime artizanale.

Në katin përdhes të ndërtesës, brenda regjimit, ndodhen shërbimet e ndryshme si:

- Farmacia, ku mbahen dhe shpërndahen ilaçet e nevojshme;
- dhoma e mjekut dhe infermiera , ku kryhen kontrolle shëndetësore rutinë, e pajisur me (EKG, aparat oksigjeni, deflibilator, frigorifer për mbajtjen e medikamenteve, oksimetër) gjithashtu mbahen dhe medikamentet e emergjencës;
- dhoma e stomatologut, për nevojat dentare të të dënuarve, nga inspektimi konstatuam se mungonte poltroni dentar për ofrimin e këtij shërbimi,
- dhoma e grupit të sigurisë, që monitoron dhe menaxhon masat e sigurisë së brendshme;
- 1 dhomë e prindërimit ku mundësohen takimet me fëmijët;
- 2 dhoma takimesh me familjarët, njëra për gratë e paraburgosura dhe një për të dënuarat;
- dhoma e takimeve me avokatët;
- dhoma e bisedave online me familjarët të të burgosurave;
- kuzhina e institucionit sëbashku me magazinat për mbajtjen e ushqimeve. Në kuzhinë ishin të punësuar 4 kuzhinierë të pajisura me librezë shëndetësore. Ambienti ishte i pasur, menyuja ushqimore paraqitej e larmishme si dhe kampionët ushqimor ishin mbajtur në rregull sipas vakteve ushqimore.

Vlen të theksojmë se të gjitha ambientet paraqiteshin në kushte të mira higjieno sanitare të lyera dhe të dezinfektuara rishtazi.

IEVP Pojskë është e pajisur me 3 bokse ajrimi ndër të cilat një boks për të paraburgosurat, një boks për të dënuarat dhe një boks për sigurinë e lartë. Nga inspektimi konstatuam se në këto bokse ajrimi mungonin strehat, sipas intervistave me të burgosurat ato e kishin të pamundur në ditët me shi të kryenin këtë aktivitet.

Gjithashtu institucioni ka dhe një ndërtesë lavanderie e pajisur me 2 lavatriçe dhe 2 tharëse të cilat ishin të reja dhe të mjaftueshme për të gjitha të burgosurat.

Regjimi dhe aktivitetet

Sektori i çështjeve shoqërore në organikën e tij përbëhej nga: 1 përgjegjës sektori (vend vakant në institucion), një psikolog dhe një specialist punonjës social. Dokumentacioni i stafit psiko-social ishte i rregullt dhe i plotësuar me raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori. Stafi dispononte dosjet psiko-sociale dhe programet individuale të trajtimit për të dënuarat me probleme të shëndetit mendor, për grup moshën 18-21 vjeç dhe abuzuesit me substancat.

Sa i takon mbështetjes psiko-sociale që merrnin të dënuarat/ paraburgosurat, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroreshin ishin të shumta dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit organizimi i festave të ndryshme, punime krijuese, gatimi i përbashkët në kuzhinën e institucionit.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato ishin të plotësuara relativisht mirë, me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë. Në dosjet ishin përfshirë programet individuale të trajtimit dhe vlerësimet periodike të cilat ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarat, vlerësimet tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Në bibliotekën e institucionit, gjendej një numër i konsiderueshëm librash që vireshin në dispozicion të të paraburgosurave /dënuarave për lexim sipas kërkesave. Të paraburgosurat dhe të dënuarat e regjistruara kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave.

Përgjatë inspektimit në ambientet e brendshme të institucionit konstatuam se ishin afishuar në çdo sektor të drejtat e të paraburgosurave dhe dënuarave dhe ishin të lexueshme përgjatë kalimit në korridor. Në lidhje me orarin e ajrimit u konstatuan se ajrimi ditor zgjaste deri 3 (tre) orë dhe ky orar ishte edhe më i gjatë për periudhën e verës.

Aktualisht në IEVP Pojskë zhvillohej kursi i rrobaqepësisë ku pjesëmarrëse ishin 19 të paraburgosura dhe 7 të dënuara.

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Drejtësisë nr. 4137 Prot., datë 18.07.2024, *“Për arsimimin e individëve në institucionet e burgimit në Republikën e Shqipërisë”*, në I.E.V.P. Pojskë zhvillohej procesi arsimor për vitin shkollor 2024-2025, i cili ndiqej rregullisht nga 6 të burgosura.

Vlen për t’u theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri të të dënuarave në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se “regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”.

Përgjatë inspektimit në IEVP Pojskë konstatuam se në ambientet e bibliotekës ishte krijuar edhe kisha për mundësimin e ushtrimit të rriteve fetare të të burgosurave.

CPT(gjatë vizitës zyrtare 4 deri më 15 maj 2023²) u bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e nevojshme për të përmirësuar ndjeshëm regjimin e veprimtarive për të gjithë të burgosurit, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor. Qëllimi duhet të jetë të sigurohet që të burgosurit të jenë në gjendje të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës, të përfshirë në aktivitete të qëllimshme të natyrave të ndryshme (si punë, arsim, trajnim profesional, sport, dhe aktivitete rekreative/shoqërimi).

Shërbimi Shëndetësor

Gjatë vizitës në I.E.V.P Pojskë, nga intervistat me të dënuarat dhe paraburgosurat, nuk u konstatuan problematika të lidhura me shërbimin shëndetësor. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte normalisht për të sëmuret kronikë, ndërkohë shërbimi stomatologjik kishte mangësi në furnizimin me bazën materiale.

Personeli i kujdesit mjekësor në I.E.V.P Pojskë përbëhej nga 8 punonjës prej të cilëve 1 (një) mjek part - time, 1 (një) farmacist, 1 (një) stomatolog dhe 5 infermierë.

Një nga qëndrimet e CPT³ konsiston se “derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në mënyrë, që të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.

Gjatë inspektimit dhe intervistimeve të të dënuarave/ paraburgosurave, u konstatua se mendimi për shërbimin shëndetësor në përgjithësi ishte pozitiv dhe vlerësohej gatishmëria e stafit si për vizitat mjekësore në institucion, ashtu dhe për konsultat me specialistë në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve.

Gjendja shëndetësore e të burgosurave sipas problematikave shëndetësore

Në ditën e inspektimit në institucion ndodheshin **22 të sëmura kronike** gjendja e të cilave paraqitej e stabilizuar, me terapi të siguar nga skema e rimbursimit sipas marrëveshjes 3 paleshe DRSKSH - DEPO FARMACEUTIKE –IEVP, nga Depoja Farmaceutike në DPB si dhe medikamente të blera nga Fondi i Institucionit.

Nga verifikimi i regjistrave u konstatua se ishin kryer 73 vizita mjekësore si dhe 10 vizita stomatologjike.

² <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-cpt-publishes-report-on-albania.-1>

³ KPT Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues, <https://www.coe.int/en/web/cpt, viti 2023.>

Gjithashtu në institucion të burgosurave iu mundësohen: Ekzaminime laboratorike dhe imazherie, Rapid-Test Droge. Të sëmurat kronike ishin konsultuar në institucion dhe në klinikat rajonale nga mjekët specialist të sistemit të burgjeve, QSB sa herë ka qenë e nevojshme edhe sipas protokollit të trajtimit të nozologjive kronike.

Persona me probleme të shëndetit mendor sipas dokumentacionit ishin ndjekur në dinamikë nga sektori i shëndetësisë, në institucionin janë diagnostikuar dhe trajtoheshin me terapi 11 të burgosura me probleme të shëndetit mendor.

Kategoria e ish përdoruesve të lëndëve narkotike nën trajtim me terapi mbajtëse metadon 1(një) e burgosur, sasia e nevojshme e metadonit sigurohej nga Spitali Rajonal Korçë.

Farmacia në institucion ishte e kompletuar me të gjitha medikamentet e emergjencës po ashtu edhe me medikamentet për gratë të cilat kishin sëmundje kronike dhe kishin terapinë përkatëse.

Dhoma e stomatologut në institucion **nuk** ishte e kompletuar me sterilizues, karrige dhe unit (poltroni) gjithashtu mungonin dhe medikamentet e emergjencës. Vizitat në lidhje me problemet dentare kryheshin kryesisht në Qendrën Shëndetësore Pogradec.

Për shoqërimin e të sëmurve në rastin e vizitave mjekësore apo të urgjencave për në spitalin e Pogradecit, IEVP Pojskë ende **nuk** është pajisur me një automjet ambulancë.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit të mjekes, formateve të kontrollit mjekësor, regjistrin të vizitave, atij themeltar për kartelat dhe atij të rasteve të evidentimit për dhunë fizike u konstatua rregullsi në mbajtjen e tyre. Kartelat edhe regjistrat që administroheshin nga infermierët rezultuan të plotësuar mirë, të gjithë të dënuarat/ paraburgosurat ishin të pajisura me librezë shëndetësore

Nga kontrolli i dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyrën regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve etj.

Avokati i Popullit vlerëson punën e vijueshme të bërë në sistemin penitenciar për ta reformuar dhe shndërruar atë në një sistem modern e që të garantojë mirëqenien e grave të paraburgosura ose të dënuara, e cila plotëson kushtet e nenit 3 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje

të të drejtave dhe lirive’, si dhe në bazë të Nenit 81/2 pika “b” të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga DPB, për miratimin e Rregullores së Brendshme të IEVP-së Pojskë.
2. Të merren masat e nevojshme, për plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucionit, 2 punonjës të Sektorit të Çështjeve Shoqërore, dhe staf policor me 6 punonjës të rolit të mesëm.
3. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për evidentimin e punonjësve të policisë të cilët kanë shfaqur sjellje joetike në mënyrën dhe trajtimin e të burgosurave gjatë shoqërimit për në gjykatat respektive nga forcat operationale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe pajisjen e mjeteve të shoqërimit me kamera.
4. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve shoqërimi i grave të burgosura jashtë institucionit të kryhet nga personeli **i së njëjtës gjini** të grupeve të sigurisë dhe/ose forcave operationale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
5. Marrjen e masave nga DPB për zgjidhjen e problematikave lidhur me ruajtjen e rendit dhe qetësisë ndërmjet të burgosurave në IEVP Pojskë si dhe marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.
6. Marrjen e masave të nevojshme për plotësimin e vendit vakant të mjekut me kohë të plotë me 2 mjekë me kohë të pjesshme në institucion.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për vendosjen e mbulesave të bokseve të ajrimit, për të ndaluar futjen e ujit në kohë me shi.
8. Marrjen e masave për kompletimin e dhomës së stomatologut me unit dentar dhe medikamentet në mungesë.

9. Marrjen e masave për pajisjen e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Pojskë me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit në përputhje me nevojat shëndetësore të të burgosurave.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI